



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1411_10_15**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **03.12.2015**

në seancën e mbajtur më datë 28 janar 2016, nxori këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e konsumatorit Sh.K. (parashtruar nga E.G) me shifër DPR- 90026380 ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II Mbetet në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1411_10_15** i datës 30.10.2015.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 03.12.2015 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori Enver Gashi shifra e të cilit identifikohet në KESCO në emër të Shefqet Kiqina me shifër DPR 90026380 i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE për keto shkaqe: 1. Për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak të shkeljes së të drejtës materiale dhe vendimit mbi borxhin e energjisë elektrike. Konsumatori në ankesë ka theksuar se shpenzimet e krijuara në këtë pikë matëse (byfe) nuk i takojnë parashtruesit Enver Gashi, por që të njëjtat janë krijuar nga konsumatori Shefqet Kiqina i cili sipas tij ka qenë krijues i borxhit të kontestuar.

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se me datë 13.06.2013 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, dhe kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruar në njehsorin elektrik nr. 32264074, ku TL=37546 kWh dhe TU=29754 kWh. Në procesverbal punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë theksura se konsumatori kërkon që t'i bëhet ndërrimi i njehsorit elektrik pasi ka harxhim të madh.

Me datë 30.10.2012 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë dalë te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 32264074 me gjendje TL=37585 kWh (tarifa e lartë) dhe TU=33838 kWh (tarifa e ulët), dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 62274722 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Punëtorët e autorizuar të KEK-ut në procesverbal po ashtu kanë theksuar se ndërrimi bëhet sipas procesverbalit nr. 1537438 dhe se njehsori paraprak dërgohet në qendrën e kalibrimit për verifikim dhe shqyrtim, si dhe kanë evidentuar pajisjet të cilat i posedon konsumatori në atë objekt.



Po ashtu me datë 05.11.2013 konsumatori ka parashtruar kërkesë zyrtare në KEDS për lidhje të re.

Me datë 10.12.2013 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruar në njehsorin elektrik nr. 13543847, ku TL=11774 kWh dhe TU=4295 kWh. Në procesverbal punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë theksuar se njehsori elektrik nuk është i regjistruar në CCP dhe se konsumatori ka bërë kërkesë për lidhje të re me datë 05.11.2013, si dhe njehsori elektrik bllobohet për shkaqe sigurie.

Me datë 14.10.2014 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEDS duke kundërshtuar borxhin e energjisë elektrike nga fillimi e deri në muajin maj 2015 që e ka krijuar Shefqet Kiqina.

Me datë 21.10.2014 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruar në njehsorin elektrik nr. 13543847, ku TL=015493 kWh dhe TU=006121 kWh. Në procesverbal punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë theksuar se kjo është gjendja reale e konsumatorit është kjo e evidentuar në procesverbal.

Pas ankesës së konsumatorit Departamenti për Konsumator në KEDS me datë 01.11.2014 i është përgjigjur konsumatorit duke e aprovuar pjesërisht ankesën e konsumatorit bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike, dhe duke korrigjuar konsumatorin në vlerë prej -62.04€ për shkak të faturimit pa matje të muajit 08/2014 dhe atë sipas procesverbalit nr. 1794876 të datës 21.10.2014.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 28.01.2016 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga ana e konsumatorit Enver Gashi dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE-së pas shqyrtimit të ankesës së konsumatorit ka konstatuar se nuk është kontestues fakti se shifra e konsumatorit DPR – 90026380 është faturuar me shpenzime që nga periudha 10/2002 dhe se borxhi i mbledhur i energjisë elektrike deri në periudhën kontestuese (maj 2013) është krijuar në vlerë financiare prej 7,601.27€ dhe e cila evidentohet në emër Byfe Shefqet Kiqina.

Po ashtu gjatë analizës së bërë transaksioneve të konsumatorit është vërtetuar se konsumatori me datë 21.06.2005 në këtë shifër është lidhur një kontratë për riprogramin e borxhit ku i njëjti është pajtuar me borxhin kontestues.

Po ashtu nga transaksionet e konsumatorit vërtetohet se i njëjti është ngarkuar nga KEK-u me faturën e shfrytëzimit të paautorizuar (rikthim i humbjeve) në vlerë prej 3,695.36€. Gjithashtu edhe me datë 04.02.2014 konsumatori është ngarkuar me një faturë tjetër të energjisë elektrike prej 2,631.16€.

Gjithashtu vërtetohet se me datë 20.02.2014 prapë konsumatori është ngarkuar me faturën e shfrytëzimit të paautorizuar (rikthim i humbjeve) në vlerë prej 3,498.93€ dhe se vlera e borxhit të përgjithshëm duke i përfshirë të gjitha këto ngarkesa deri në periudhën 02/2014 ka qenë 13,780.39€. Nga transaksionet e konsumatorit vërehet se prej periudhës 10/2012 e deri më 12/2013 konsumatori është faturuar me vetëm me taksa dhe pa shpenzim, dhe se nga periudha 01/2014 ka filluar prapë të faturohet me shpenzim të energjisë elektrike.

Ky pasqyrim tregon se nuk është kontestues fakti se pika matëse është ngarkuar me vlera të mëdha financiare duke përfshirë krijim të borxhit përmes shpenzimit të energjisë elektrike, ndëshkime/ngarkesa për raste të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë, po ashtu nuk është kontestues fakti se shfrytëzuesi i kësaj pike matëse ka lidhë kontratë për riprogramim të borxhit të energjisë elektrike që do të thotë se është pajtuar për pagesën e atij borxhi, andaj mbi këtë bazë



Bordi ka konstatuar se DMK si organ i shkallës së parë, në vendimin e nxjerr i ka paraqitë në mënyrë të drejt gjithë procesin e zhvilluar në këtë pikë matëse.

Bordi duke analizuar ankesën e konsumatorit ne asnjë rrethanë nuk ka vërtetuar se konsumatori Enver Gashi e ka kontestuar borxhin e krijuar në këtë pikë matëse deri në periudhën e muajit maj 2013 por që vetëm është thirr ne atë se ky borxh i takon shfrytëzuesit të lokalit Shefqet Kiqina.

Bordi po ashtu konstaton se ndërmarrja e energjisë me te drejt ka vepruar ne rastet kur ka kërkuar borxhin e krijuar në pikën matëse pasi që një veprim i tillë është i paraparë edhe me dispozita ligjore në fuqi. Sipas nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji theksohet: **“konsumatorët kanë obligimin që të paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja.** Për më tepër Bordi ka konstatuar se ZRRE sipas mandatit ligjor që ka të drejt të zgjedh ankesa që kanë të bëjnë në mes furnizuesit publik dhe konsumatorit, por që jo edhe të zgjedh mosmarrëveshje ne mes palëve për çështje të ndryshme për këtë çështje kompetente është vetëm gjykata.

Konsumatori në ankesë ka theksuar se DMK me rastin e vendosjes së kësaj çështje juridike, ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Lidhur me këtë Bordi ka konstatuar se vendimi i DMK-së, është vendim i drejt i bazuar në prova dhe fakte konkrete dhe gjithashtu është në përputhje të plotë në ligje dhe rregulla që janë fuqi.

Bordi po ashtu ka konstatuar se organi i shkallës së parë DMK, ka vepruar drejt kur është thirrur në dispozitat ligjore nga neni 4 paragrafi 2 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, ku theksohet: **“Çdo ankesë ose kontest që lidhet me elementet e veprës penale dhe vjedhjes së energjisë elektrike, të përcaktuara në nenin 39 të Ligjit për Energji Elektrike, janë nën juridiksionin e gjykatës kompetente, andaj këto ankesa ose konteste nuk trajtohen në këtë rregull, që nënkupton se ZRRE nuk ka bërë shqyrtimin e faturave që kanë të bëjnë me shfrytëzim të paautorizuar te energjisë elektrike.**

Bordi i ZRRE-së gjithashtu ka konstatuar se KESCO ka respektuar saktë nenin 23 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ku thuhet se: **“1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shfrytëzuar dhe për taksat e tjera, në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme)”. “2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Furnizuesi ose Operatori i Sistemit për konsumatorët me tarifa të rregulluara në bazë të tarifave të miratuara nga ZRRE-ja, dhe për konsumatorët e kualifikuar (me çmime të parregulluara) ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim”.**

Bordi ka konstatuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë në marrjen e vendimit te shkallës së parë pasi që janë analizuar në detaje rrjedhat e energjisë elektrike për këtë pikë matëse dhe janë vërtetuar saktësisht të dhënat e kilovatëve të marra në njehsorin elektrik me gjendjen e kilovatëve të evidentuara edhe në rrjedhën e energjisë elektrike, që nënkupton se çdo shpenzim i bërë nga ana e konsumatorit është regjistruar në mënyrë të drejt.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejt dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar. Bordi ka konstatuar se ankesa e konsumatorit nuk është e bazuar në prova dhe fakte konkrete, por që ka konstatuar se vendimi i DMK-së është vendim i drejt dhe i bazuar në ligje dhe rregulla në fuqi.



Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.01.2016 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1411_10_15, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Enver Halimi, kryesues

Krenar Bujupi, anëtar

Arsim Janova, anëtar

Qemajl Mustafa, anëtar

Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit Enver Gashi,
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.